



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. „Radio Start“  
Pronar - Liridon DURGUTI  
RADIO START  
Xhelal Hajda –Toni pn  
Rahovec

Ref:1510/1302/LIC/ni

### Vendim

*për ndërprerjen e licencës së transmetimit të Radio Start, me seli ne Rahovec*

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Start është subjekt transmetues me mbulueshmëri lokale, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për të transmetimin e radio programeve në Komunën e Rahovecit, me seli në Rahovec, në regjionin e Prizrenit. KPM, me datën 6 tetor 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës afatgjatë për Radio Start.
3. Me datën 6 maj 2015, përmes një raporti të Departamentit të Monitorimit të KPM-së, është njoftuar se, gjatë një vizite në teren është konstatuar se Radio Start ka ndryshuar lokacionin e studios dhe për këtë veprim nuk ka njoftuar KPM-në, gjithashtu, ka ndryshuar edhe numrat e kontaktit të telefonit dhe në këtë mënyrë, ka qenë e pamundur që të kontaktohet dikush nga personeli i këtij radio stacioni.
4. Me datën 27 maj 2015, zyrtarët e Departamentit për Menaxhim të Frekuncave (DMF) të KPM-së, kanë bërë një vizitë në teren për të vertetuar nëse Radio Start është duke transmetuar. Në bazë të matjeve të bëra ka rezultuar se Radio Start nuk është duke transmetuar.

1/3

5. Poashtu, përmes një raporti të monitorimit, të datës 1 qershor 2015, është njoftuar se gjatë një vizite të radhës në terren, është bërë përpjekje që të kontaktohet me Radio Start, mirpo, ka qenë e pamundur. Ndërsa, një përfaqësues i një radio stacioni tjetër, i cili operonë në këtë regjion, ka njoftuar zyrtarët e KPM-së, të cilët kanë qenë në teren se, pronari i Radio Start ka shitur të gjitha paisjet e radios, ndërsa, ai së bashku me familje ka imigruar në Kanada.
6. Lidhur më ndërprerjen e transmetimit të programit, Dpartamenti i Licencimit i KPM-së, me datën 7 tetor 2015, i ka dërguar letër Radio Start me anë të së cilisë është udhëzuar që brenda 5 (pesë) ditëve, nga dita e pranimit të letrës, të informojë KPM-në lidhur me arsyet e ndërprerjes së transmetimit, si dhe për hapat të cilët i ka ndërmarrë për fillimin e transmetimit të programit të Radio Start.
7. Radio Start asnjëherë nuk ka ofruar përgjigje në shkresat e KPM-së.

### Arsyetimi

8. Komisioni konstaton se, Radio Start ka vepruar në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, duke ndryshuar lokacionin e studios, numrat e telefonit kontaktues e të dhënat tjera të kontaktit dhe për këtë nuk e ka njoftuar KPM-në, ashtu siç përcaktohet me Nenin 6, paragrafi 1.2. i këtyre kushteve:

*“I Licencuari obligohet që brenda pesë (5) ditëve të punës të informojë KPM-në për ndryshimet në të dhënat e mëposhtme. Të gjitha këto do të trajtohen nga KPM-ja si të dhëna të hapura për publikun:*

*“Të dhënat e adresës së të licencuarit, telefoni, fakti ose informacione të tjera kontakti;”.*

9. Gjithashtu, Radio Start ka vepruar në kundërshtim të plotë me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, duke ndërprerë transmetimin e programit dhe për këtë nuk e ka njoftuar fare KPM-në, ashtu siç përcaktohet me Nenin 6, Paragrafin 1.8. të këtyre kushteve:

*“Ndërprerje të transmetimit më të mëdha se programi i planifikuar i një (1) dite të plotë.”*

10. Së fundmi, Radio Start nuk është përgjigjur në shkresën e KPM-së, të datës 7 tetor 2015, përmes së cilës është udhëzuar të ofrojë informacione brenda 5 ditëve, lidhur me arsyet e ndërprerjes së transmetimit të programit.

11. Komisioni konstaton se, Radio Start ka vepruar në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës

për Licencë (KPM-2014/03), si dhe Ligjin e KPM-së, edhe për faktin se nuk i ka shlyer obligimet ndaj tarifës vjetore të licencës për vitet 2013, 2014 dhe 2015.


12. Duke marrë parasyshë veprimet e Radio Start, në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë, Ligjin e KPM-së si dhe udhëzimet e KPM-së, Komisioni konstaton se, ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e licencës së transmetimit për Radio Start.

### Vendim

13. Komisionit në takimin e mbajturme datën 8 dhjetor 2015, merr vendim për ndërprerjen e licencës së Radio Start, ndërsa, procedurat për shlyerjen e obligimeve ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së, mbetet të zbatohen në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

### Lëshimi i Vendimit

14. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.

  
Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



10.12.2015

datë